

**Njoftimi i përqendrimit ndërmjet BIG Energia Holdings Kft., Hungari dhe Skaj Solar SHPK,
Republika e Maqedonisë së Veriut**

(lënda nr. 08-154/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 21.11.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga BIG Energia Holdings Kft., me seli në 1055 Budapest, rr. Marko 7.6 kati 8, Hungaria mbi Skaj Solar SHPK, Shkup me seli në rr. Ivan Agovski nr. 11/1-10 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

BIG Energia Holdings Kft., është 100% në pronësi të BIG Shopping Centers Ltd, e cila është një kompani holding e kompanive, kryesisht në biznesin e pasurive të paluajtshme me aktivitet në SHBA, Izrael, Serbi, Mal të Zi dhe Francë. BIG Shopping Centers Ltd. është lider në ndërtimin dhe zhvillimin e konceptit të qendrave tregtare në natyrë në Izrael dhe më gjerë. Në vitet e fundit, BIG Shopping Centers Ltd. dhe BIG Energia Holdings Kft., kanë investuar në sektorin e energjisë elektrike.

BIG Energia Holdings Kft., ka këto kompani në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

BIG MEGA Maqedonia - Shtip Solar One SHPKNJ Shkup me seli në rr. Naum Naumovski Borçe nr. 40 kati 5 lokacioni 8 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar më 12.10.2022, me aktivitetin kryesor të prodhimit të energjisë elektrike, i cili është në fazën e zhvillimit të termocentralit për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet diellore - fotovoltaike.

BAKA ENERXHI SHPK Shkup me seli në rr. Qemal Sejfula nr. 7B Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,

ÇASHICA SOLAR SHPK Shkup, me seli në bul. ASNOM 72-1/3, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,

BAKA ENERXHI SHPK Shkup dhe ÇASHICA SOLAR SHPK nuk janë aktive në treg, përkatësisht janë në fazën zhvillimore të projektit për ndërtimin dhe sigurimin e të gjitha licencave të nevojshme për një termocentral për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet diellore - fotovoltaike.

Skaj Solar është në fazën e zhvillimit të projektit për ndërtimin dhe sigurimin e të gjitha licencave të nevojshme për një termocentral për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet diellore – fotovoltaike.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si tregje relevante, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit, mund të përcaktohen: **tregu i telefonisë fikse, tregu i aksesit në internet me brez të gjerë fikse dhe) tregu i shpërndarjes së përmbajtjeve mediatike**, të gjitha në nivel të shitjes me pakicë.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

28.11. 2022

Shkup